

ESE ÇARSHIA E BËN DIFERENCËN

“Shkruaj sepse nuk mund të mos shkruaj”, në kohën e fundit “jo numra e relacione” por “shkronja e fjali”. “Sa më shumë të shkruash”, aq më shumë “të shtohet dëshira për të shkruar”. U përpoqa “të shkruaj sa më pak”, “për të lexuar ju sa më shumë!”

Ngarendja “për të hyrë në histori” në të gjallë, ka shtytje të madhe. Është frikë se, po qe se nuk e bën vetë, sa je “gjallë” dhe “i fortë”, nuk do ta bëjë kush, kur të vdesësh. Kur të “përsëndetesh” nga kjo botë, do të ketë shqiptarë të tjerë të gjallë, që do të ngarendin “ta fusin vetën në histori”, duke i zënë vendet në atë hapësirë, gjithnjë e më të ngushtë.

Shpesh kam hyrë në “pyje”, madje do të thosha edhe në ato të “pashkelura” dhe gjithnjë “kam shëtitur” vetë, pa përcjellës për t’u ngjitur deri në “maje”, nëpërmjet “rrugicave” fare të ngushta, të shtruar me **“ferra, gjemba, driza e murriza”**, ku aty pari kishin kaluar vetëm dhitë. Ky **“rrugëtim” ishte shumë i gjatë**, me zigzage, me shumë të “papritura” dhe me shumë “rreziqe”. Megjithatë, s’jam pishman që “shëtita pa përcjellës”, meqë “për një punë që mund ta kryesh vetë, mos kërkohet ndihmë nga të tjerët”.

Herën e fundit të ngjitjes sime, para meje në “maje” kishin shkelur Laro me shokë Tarafi i tyre **“Hermetizmi 2000”** kishin zgjedhur një “dru të madh”, nën të cilin “ishin ulur këmbëkryq”, me “qendër gjithnjë nën hije”. Tek ata nuk gjeta një adresë ku mund të kthehem.

Laro me shokë në “maje” kishin sjellë hiç më pak se “gjashtë flamuj”, prej të cilëve tre ishin “të lirisë” dhe tre të tjerë “të dëturisë”. Nga goja e tyre doli që “flamujt e dëturisë” i kishin “qëndisur mbrëmë vonë”, nëpërmjet një “bedeli”, po ashtu “hermetikë”. Edhe pse bëhej fjalë për “flamuj të birësuar” megjithatë “shtizat” e tyre ishin ngulitur në “maje”!

Afria me Laron dhe shokët e tij, në ato “rrethana” nuk ishte pa rrezik, meqë ata ishin **“pjekë dhe djegë nën dritën e Hënës” në zbatim të “ligjit të xhunglës”: Ushqehu ose prit të ushqehem me ty”. Secili veç e veç ishte “ujk në lëkurën e dashit”!**

Derisa **“unë jam ai që jam dhe nuk bëhem ai që s’jam”, ti Laro, je ai që je dhe shtires ai që s’je**. Le t’i mbetet çarshisë, ajo e “bën diferencën”. Çarshia ka kohë për gjithsecilin “të merret vetëm njëherë”!

I “mbështjellë” me “flamurin e lirisë”, Laro zuri “kryet e vendit”, për të marrë më pas “nam” emri i tij, duke u futur edhe në “botën akademike”. Çarshia e di fortë mirë që **ai nuk është i fortë “as nga goja” dhe “as nga lapsi”**. Dhe **nuk janë librat për gjithkë**, andaj s’mund t’i kuptoj e aq më pak t’i shkruaj gjithkush”!

**“Ti more “berim”,
nuk ke këndim,
si do punosh,
më tej në arsim”?!**

Duke lakuar llagapin e Laros, bie në sy që “të parët e tyre” kanë ruajtur **“njën shquese” ei**, lidhur me **pronësi**. Kishin “nënshkruar” me nga “një gisht” tapitë për “njerëzit” dhe “kafshët”; “malin” dhe “fushat”; “ujërat” dhe “qiellin”; “kohën” dhe “hapësirën”... Laro një “e- ime” të “djeshme”, padrejtësisht e shndërroi në një “e- ime” të “sotshme”. “E- ime” ka dëshmitarë nga “Çarshia e madhe”, “Çarshia e Vogël”,

“Çarshia e gjatë”, “Fusha e Bajram Pashës”, “Fusha e Sahatit”, “Çarshia e moçme”, “Çarshia e re”..

Në vendin e punës, në mesin e njerëzve ku “nuk kishte persona”, Laro vodhi “votën”, “botën” dhe “notën”. **“Pa e ditur mirë asnjë gjuhë”, “ai këndoi në çfarëdo lloj gjuhe”!**

Në ndërkohë “u zbulua” që Laro me shokë, kishin “falur” edhe atë që nuk “falet” dhe “shitur në bllok” edhe “atë që nuk shitet”. **“Ai që ta jep herët apo vonë, ka për ta përmendur”**. “Rasti i Laros me shokë” kaloi tek “Kadiu” dhe “Myftiu”. U krijua zhurmë, shumë zhurmë, shumë më shumë zhurmë. Përveç që **“u bënë natë në fytyrë”** dhe **“çarshia i bëri përrallë me tupan”**, duke i futur në **“gojën e botës”**, Laro me shokë, **“nuk e gjetën atë që kërkonin”** (“flladin”) dhe kjo për një arsye të thjeshtë: Të gjithë veç e veç, kanë “dajë me shpinë të fortë”.

Mbaj mend kur isha fëmijë, “zbulimi” i një “numërori të shitur,” të shkruar në çfarëdo lloj libreze, “misionarin e dijës” e shpinte në “fllad” gjashtë mujor, duke ia “dhuruar” edhe “kartonin e kuq”, pa të drejtë ankese! Edhe për ata që merrnin “peshqeshe të majme” ndiqej “veprimi i njëjtë”.

“Çarshia ka regjistruar” që Laro me shokë, në dekadën e fundit, më shumë se 20 herë pranoi **ndërhyrje nga “lartë”**, për t’iu lëshuar në dorë, “brenda një muaji”, “librezat” e plotësuar me numërorë, dhe po kjo për **“myshterinj pa portofol”** me prejardhje nga “Bregu i Diellit”, me qëllim (ri)punësimi të familjarëve të tyre (duke promovuar njerëzit që kanë “miq” dhe shpërfill njerëzit “pa krahë”). “Çarshia i ka parë me sytë e vet”, kur **“numërori” i shkruar në “Medresenë e Bregut të Diellit” i “mbarsur” në “Medresenë tek Bunari” brenda muajit “pjelli” edhe nëntë numërorë të tjerë**, të ngjashëm. Kësaj radhe “hëngrën dardha” edhe dhjetë të tjerë që ishin “nën dardhë”. Unë atë ditë “nuk dola në çarshi”, meqë “isha ai që jam”.

Për “myshterinj mediokër”, dje dhe sot ka zënë të fitojë terren gjithnjë e më shumë një agjent tjetër ndërhyrjeje: **paraja**. Sot **mund të trokasësh me njëren dorë në derën e “mikut”, por në dorën tjetër duhet të kesh se s’bën një zarf me para përndryshe mbetesh “pa librezë të plotësuar”!**

Duke qenë vetë “shteti” dhe “pushteti” po punoni në “disa mënyra” “me dorëza” dhe me “dorë të zgjatur”, me kostume “ngjyrash” dhe “xhepush” ndër më të ndryshëm, “me kapak” dhe “pa kapak”. **Në këta xhepa në cilësinë e “municionit”, ju ende mbani “libreza” të “formatit”, “ngjyrave” dhe “simboleve” të ndryshëm, “me adresë” dhe “pa adresë”, pronë e të (pa)punësuarve që (s)dinë “shkrim-këndim”, vetëm sa për të thënë se “po punon diçka”. “Çarshia” e di që **“librezat” dorëzohen tek “Kryet e pazarit”, te “Bunari”, duke pi “kafe me sheqer pluhur”**. Nuk prish punë po qe se “sheqeri është kokërr”. **“Puna me regjistra” kryhet të shtunën dhe të dielën “pa dëshmitarë”!****

Laro, “çarshia ta garanton” se do të mbetesh në “kujtesën historike të brezave” për paaftësi, për ta ngritur “Kalanë e diturisë” aq shumë të aspiruar nga popullata vendore. **Nuk ishe personi i duhur, në kohën e duhur dhe në vendin e duhur !**

Sot në vend të dijeve, zotësive dhe ligjëorisë, po shpalosen miqtë, paraja dhe gatishmëria për t’i shërbyer “lirisë”.

A thua si do t’iu mbushim mendjen fëmijëve tanë: Se të studiosh, të marrësh dije e të bëhesh i zoti, jo vetëm ka një kuptim, por ka edhe dobi!

“Ka ndonjë budalla që e beson këtë”?

Punimi u shkrua me rastin e fillimit të Vitit të Ri shkollor 2010 / 2011.

1.shtator.2010.